



BASHKIA MIRDITË

Buletini i Muajit Qershor 2025

30.06.2025

Ambasadorja Austriake vizitë në Bashkinë Mirditë.



Më datë 13 qershor 2025 mirëpritëm në Bashkinë Mirditë Shkëlqesinë e Saj, znj. Monica Zach, Ambasadore e Austrisë në Shqipëri.

Gjatë takimit u diskutua mbi funksionimin e qeverisjes vendore, projektet në zhvillim dhe sfidat me të cilat përballet Bashkia në përditshmëri.

Kryetari i Bashkisë, z. Albert Melyshi, vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme që Austria ka dhënë ndër vite për komunitetin e Mirditës, si dhe kontributin e çmuar të znj. M. Graf – një mike e vërtetë e mirditorëve – e cila ka ndikuar konkretisht në përmirësimin e jetës së banorëve të zonave të thella.

Kjo vizitë përforcon më tej urat e miqësisë dhe bashkëpunimit, duke hapur perspektiva të reja për zhvillimin e mëtejshëm të Mirditës

Koncert klasik në Kishën e T'Shëlbuemit.

Në ambientet e Kishës së T'Shëlbuemit në Rubik, një prej monumenteve kishtare më të hershme dhe të rëndësishme të Shqipërisë Veriore, me vlera të rralla fetare, historike dhe kulturore, u zhvillua një koncert klasik nga duoja austriake e talentuar: Rosa Franziska Maier (kitare) dhe Anna Maria Niemiec (violonçel).

Me një repertor të përzgjedhur me delikatesë, artistet sollën një përjetim të thellë muzikor, ku tingujt e pastër dhe emocionues u ndërthurën në mënyrë të përkryer me atmosferën e shenjtë dhe magjinë historike të kishës.

Një mbrëmje ku arti, muzika dhe trashëgimia u shkrinë në një përvojë unike dhe të paharrueshme për të gjithë të pranishmit.



Ekspozita fotografike : “Personalitete historike nga Mirdita”.

Më datë 25.06.2025 në hollin e Bashkisë Mirditë, u organizua ekspozita fotografike me titull: “Personalitete historike nga Mirdita”.

Në këtë ekspozitë u prezantuan fotografi të personaliteteve të shquara mirditore, të cilët kanë lënë gjurmë në historinë e Mirditës dhe në trashëgiminë tonë kombëtare.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, u shpreh se këto personalitete përfaqësojnë vlerat më të mira të vendit dhe janë një shembull frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, si dhe fotografitë e tyre do të vendosen në ambientet e Bashkisë Mirditë, si një vlerësim dhe kujtesë e përhershme për kontributin e tyre .

Kjo ekspozitë shërben si një kujtesë vizuale e trashëgimisë së pasur që mbart Mirdita dhe një nxitje për të ruajtur e promovuar më tej vlerat tona historike e kulturore.



Qendra Kulturore e Fëmijëve Mirditë.

Qendra Kulturore e Fëmijëve – Mirditë ishte pjesë e edicionit të 21-të të Festivalit Mbarëkombëtar të Instrumentistëve të Vegjël Popullorë, organizuar çdo vit në Fushë-Arrëz.

Ky festival tashmë i kthyer në traditë, ishte një përvojë e jashtëzakonshme artistike për fëmijët dhe organizatorët.

Mes shumë grupeve pjesëmarrëse nga treva të ndryshme shqiptare, instrumentistët e vegjël të QKF-Mirditë u vlerësuan me Çmimin e Parë, me motivacionin: “Për performimin me cilësi të lartë.” Ky vlerësim përfaqëson një shpërblim të merituar për talentin dhe përkushtimin e fëmijëve tanë dhe të mësuesve të tyre si dhe një nxitje për të vijuar rrugëtimin artistik me pasion dhe seriozitet



Këshilli Rinor i Bashkisë Mirditë .

Është zhvilluar mbledhja e parë konstituive e Këshillit të Ri Rinor Vendor Mirditë , një strukturë këshillimore që synon të përfaqësojë zërin e të rinjve dhe të kontribuojë në përmirësimin e politikave rinore në nivel vendor.

Në këtë takim u diskutuan:

- Roli dhe funksioni i Këshillit Rinor
- Prioritetet dhe temat me interes për të rinjtë.
- Hapat e parë për organizimin e aktiviteteve rinore në territorin e Bashkisë Mirditë.

Bashkia Mirditë falenderon të gjithë të rinjtë për angazhimin e treguar dhe shpreh vullnetin për të vijuar mbështetjen e tyre në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar.



Përralla e ngatërruar e gjyshes” – në skenën e fëmijëve.

Ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Rrëshen u mbushën me gëzim dhe atmosferë festive, me rastin e shfaqjes teatrale për fëmijë: “Përralla e ngatërruar e gjyshes”.

Kjo vepër skenike solli për publikun një kombinim të këndshëm personazhesh të njohur nga bota e përrallave, të interpretuar me entuziazëm, pasion dhe shumë imagjinatë nga vetë fëmijët.

Shfaqja përçoi mesazhe të bukura për miqësinë, fantazinë dhe fuqinë e bashkëpunimit, duke treguar njëherazi edhe talentin e të vegjëlve në artin skenik.

Një iniciativë që nxit krijimtarinë dhe dashurinë për teatrin që në moshë të hershme.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë.

Me datë 19 Qershor 2025 u zhvillua mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë ku u miratuan projekt-vendimet e mëposhtme:

1. P/Vendim nr. 2294/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, për periudhën 01 - 31 Maj 2025”, bashkia Mirditë .
2. P/Vendim nr. 2369/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondine bashkisë, për periudhën 01 - 31 Maj 2025”, bashkia Mirditë.
3. P/Vendim nr. 1930/3 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e rikonstruksionit së rrugës ekzistuese automobilistike që fillon nga fshati Perlat Epër, njësia administrative Kthellë, 4606, deri në lagjen Trangë, fshati Lufaj, njësia administrative Selitë, 4604”, bashkia Mirditë.
4. P/Vendim nr. 741/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e hapjes së rrugës së re automobilistike që lidh fshatin Lajthizë, Njësia administrative Orosh, 4608”, Bashkia Mirditë, me fshatin Vlashaj, Bashkia Dibër.
5. P/Vendim nr. 2058 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e hapjes së rrugës automobilistike dalëse nga autostrada në funksion të qytetit Rubik”, bashkia Mirditë.
6. P/Vendim nr. 2059 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e zgjerimit të sipërfaqes së varrezave, në fshatrat; Rrethi i Epërm, Shpal dhe Katund i Vjetër”, bashkia Mirditë.
7. P/Vendim nr. 2040/2 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e rikonstruksionit së rrugës ekzistuese automobilistike që lidh lagjen Bungaj, fshati Tarazh me Unazën e qytetit afër Urës së Zmesë, Njësia administrative Rrëshen”, bashkia Mirditë.
8. P/Vendim nr. 2262/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin në parim të draft memorandum partneriteti dhe bashkëpunimi të ndërsjellë, ndërmjet Bashkisë Mirditë, Shqipëri & Bashkisë Pezinok, Sllovaki”.
9. P/Vendim nr. 2263/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e Dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026 - 2028”, bashkia Mirditë.
10. P/Vendim nr. 1745/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.
11. P/Vendim nr. 1977/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e tabelave të situatës financiare të Bashkisë Mirditë datë 30.04.2025”.
12. P/Vendim nr. 1805/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.
13. P/Vendim nr. 912/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.

14. P/Vendim nr. 2009 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit, 4-mujori i parë, viti 2025”, bashkia Mirditë.
15. P/Vendim nr. 1580/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.
16. P/Vendim nr. 1927/2 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.
17. P/Vendim nr. 2020/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.
18. P/Vendim nr. 1814/2 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.
19. P/Vendim nr. 2097/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e akomodimit të përkohshëm, te zona e re e zhvillimit të dy subjekteve përfitues të granteve të rindërtimit, për shkak të nevojave emergjente për strehim”, bashkia Mirditë.
20. P/Vendim nr. 2110/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për një shtesë në Vendimin nr. 7, datë 24.01.2025”, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e pagesës së qirasë për një periudhë 1 (një) vjeçare sipas vlerës së tregut, për familjet e pastrehë” bashkia Mirditë.

Gjithashtu u shqyrtuan;

- Analiza e realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave, 4 mujori I-rë 2025, bashkia Mirditë, (nr. 2036 prot, datë 26.05.2025)
- Pasqyrat Financiare Vjetore të Vitit Ushtrimor - 2024.
- Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i ushtruar në Bashkinë Mirditë, Shkurt 2025.



Mbledhia e Këshillit Bashkiak Mirditë

Infrastrukturë.

Bashkia Mirditë vijon punimet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat rurale.

Aktualisht ndërhyrjet po kryhen në:

Fshatin Tharri– Njësia Administrative Kthellë.

Drejt Kroit të Bardhë – Njësia Administrative Selitë.

Fshatin Gëziq – Njësia Administrative Rrëshen.



Vendosja e 15 hidrantëve të rinj.

Bashkia Mirditë ka ndërmarrë një ndërhyrje të rëndësishme në sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, përmes vendosjes së 15 hidrantëve të rinj, të jashtëm dhe nëntokësor, në pika strategjike të qytetit dhe njësive administrative.

Hidrantët janë vendosur në këto zona: në hyrjen e qytetit Rrëshen, pranë lagjes së re të ,Pranë Stacionit Zjarrfikës, pranë Kryqëzimit, Rrëshen në Sheshin “Abat Doci” – 3 hidrantë nëntokësorë, pranë pallateve parafabrikat, Market Conad, Rrëshen, Ura e Zmesë, Kodër – Rrëshen, Malaj, Munaz, Rubik, Mashtërkor – Orosh (autostradë).

Ky investim synon të lehtësojë furnizimin me ujë për mjetet zjarrfikëse dhe të ndihmojë në përmirësimin e reagimit në rastet e zjarreve apo emergjencave të tjera.



Për çdo kërkesë për informacion apo ankesë të drejtuar ndaj Bashkisë Mirditë, ju lutemi të plotësoni formularin përkatës dhe ta dorëzoni në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

Nëpërmjet postës elektronike: info@bashkiamirdite.gov.al

Pranë Zyrës së Informacionit, Kati I, Bashkia Mirditë

Ose me postë në adresën: Sheshi “Abat Doci” Rrëshen, 4601.

Kërkesat do të trajtohen në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore, bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe aktet përkatëse nënligjore.

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/2025 Nënshkrimi:
---------------------------------------	---	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

